

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E
RAPORTIT TE THELLUAR TE
VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
PER AKTIVITETIN MINERAR
SHFRYTEZIM I GURIT GELQEROR ME KARIERE**

Zona minerare nr.356/1, Objekti Gjorma,Elbasan

(Sipas ligjit nr. 10 440 date 07.07.2011 “ Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” perfshihet ne shtojcen 1 kodi 19).



INVESTITOR: VELLEZERIT HYSAsphk

PROJEKTOI: STUDIO PROJEKT shpk

Tiranë 2021

PERMBAJTJA E RAPORTIT

HYRJE

- 1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR**
- 2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT**
- 3. NJE PERSHKRIM I ANALIZIMIT TE ALTERNATIVAVE TE MUNDSHME PER ZBATIMIN E PROJEKTIT**
- 4. NJE PERSHKRIM TE GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR DUKE PERFSHIRE**
- 5. NJE PERSHKRIM TE NDIKIMEVE NEGATIVE TE RENDESISHME TE PROJEKTIT TE PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PERFSHIHEN**
- 6. NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT (NESE KA TE TILLA)**
- 7. NDIKIMET POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTIT**
- 8. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV TE IDENTIFIKUAR**
- 9. PROGRAMIN E MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT**
- 10. PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT**
- 11. KONKLUZIONE**

HYRJE

Shoqëria “VELLEZERIT HYSA” shpk është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT **K12911201C** me e administrator Z. Besnik HYSA, në fushën e ndertimeve industriale, banesave, ndertimit të infrastruktures rrugore, prodhim betoni industrial, asfaltbetoni, shfrytezim minerali ndertimor prodhim inerte dhe lende të para për industrinë e ndertimit etj.

Shoqëria është vënë në dijeni nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë si “Njoftim Fituesi” me shkresën Nr.4576/2. dt. 27.07.2021 “Për aplikimin për leje minerare shfrytezimi me karriere për grupin e mineraleve ndertimore për zonën minerare Nr. 356/1”, objektit **Gjorma, Rrethi Elbasan**.

Shoqëria “VELLEZERIT HYSA” shpk, kryen aktivitetin minerar shfrytezim minerali ndertimor gurit gelqeror në objektin Klos, Gostime, Elbasan me lejen minerare Nr.1536, Dt.02.03.2011 dhe në objektin Rezluk, Gjorma, Elbasan me leje minerare Nr.1304/2, dt. 26.01.2009.

Shoqëria ka administratën të ngritur me punonjës të kualifikuar dhe me eksperiencë të lartë pune, ka infrastrukturën rrugore të ndertuar, furnizimin me energji, ka investuar dhe ka në përdorim pajisje e makineri, si linjë thyerje fraksionimi për prodhim inerte, makineri e pajisje sonda shpimi, eskavatore, kamiona transporti të gurit gelqeror, me :

- a- Kapital të mbartur mbi 86 000 000lek.
- b- Vlera e investimit që parashikohet të investohet 208 166 667leke
- c- Prodhimi i projektuar 450 000m³

Raporti teknik për aktivitetin minerar, shfrytezim të gurit gelqeror me karriere në objektin Gjorma, rrethi Elbasan, u përgatit në përputhje të legjislacionit Shqiptar dhe standardeve të Bashkimit Evropian. Projekti synon vlerësimin e ndikimeve baze të mjedisit në territorin e aktivitetit minerar, zonën për rreth dhe masat që duhet të marrin në konsideratë për të parandaluar, minimizuar, zbutur ato.

Projekti përcakton masat për menaxhimin specifik të mjedisit dhe planet monitoruese dhe raportimeve dhe vetmonitorimit.

BAZA LIGJORE

- VKM nr.686 date 29.7.2015 « *Per miratimin e rregullave, të përgjegjesive e të afateve për zhvillimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurave të transferimit të vendimit e Deklaratës Mjedisore* »
- Ligj nr 12/2015 për disa ndryshime në ligjin nr. 10440 date 07.07.2011 « *Per vlerësimin e ndikimit në mjedis* »
- VKM nr. 435 date 12.09.2015 « *Per miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë* »
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 “*Per miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte*”
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « *Per miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A,B dhe C për transferimin e lejeve nga një subjekt tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në leshimin e këtyre lejeve nga QKJja.*
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “*Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore*”
- Vendim nr. 13 date 4.1.2013 « *Per miratimin e rregullave, të përgjegjesive e të afateve për zhvillimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis* »
- VKM nr. 765 date 07.11.2012 “*Per miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura*”

- Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »
- Ligj Nr 10304, datë 15.7.2010 “Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja” per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Udhëzimin nr.12 date 15.06.2010 per disa ndryshime ne Udhëzim nr. 6527 date 24.12.2004 “Mbi Vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollit te tyre”
- Urdhri e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 “Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”
- Udhëzimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”
- Udhëzim Nr 3, datë 17.05.2006 “Për planet e rehabilitimit të sipërfaqeve të dëmtuara nga guroret”
- VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. Të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
- Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin te mbeturinave »

QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

Qellimi i projektit te propozuar nga shoqeria “VELLEZERIT HYSA” shpk eshte shfrytezimi i gurit gelqerore me kariere , ne zonen minerare nr. 356/1 , qe do te perdoret si lende e pare ne ndertime ne infrastrukturen rrugore, objekte kombetare, evidentimi i ndikimeve ne mjedis dhe masat per eliminimin dhe minimizimin e tyre .

Kjo zone eshte e preferuar per shfrytezimin e gurit gelqerore me kariere me punime siperfaqesore sepse ndodhet ne afersi te zonave urbane qytetit Elbasan dhe Tiranes, rrugeve nacionale Elbasan -Tirane, Elbasan - Rrogozhine, Elbasan-Belsh, nepermjet tyre mund te trasportohen lendet e para inerte, per industrine e ndertimit, etj .

Nga pikpamja geografike terreni ku ndodhet objekti per shfrytezim « guri gelqeror » eshte terren malor , ne forme kurrizore, me renie te forte ne drejtim te jugut.

Persa i perket referencave per harten kadastrale pyjore dhe procedures per heqjen nga fondi pyjor e kullosor, fillojne mbasi shoqeria pajiset me leje mjedisore dhe minerare.

Kerkesa per heqjen nga fondi pyjor e kullosor dregohet ne Ministrine e Turizmit dhe Mjedisit, nga ministria e Linjes, Ministria e Infrastruktures dhe Energjise ne zbatim te Ligjit Nr.10 304 “Per Sektorin Minerar ne Republikën e Shqiperise”, me ndryshimet e Ligjit Nr.9/2013,Ligjit Nr 134/2014, neni 24 pika 10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ben heqjen nga fondi pyjor ne baze te vendimit nr.1374 date 10.10.2008 Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe

« VELLEZERIT HYSA »shpk

ndryshimin e destinacionit te fondit kullosor, vendim nr.435 date 8.6.2016 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1374 date 10.10.2008 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave, qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit Kullosor”, Vendim nr.1353 date 10.10.2008 Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses, mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kritereteve te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor, Vendim nr. 434 date 8.6.2016 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1353 date 10.10.2008 te keshillit te ministrave Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses , mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kritereteve e te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor”

b. Planimetria e vendodhjes se projektit, harta topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksistues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret ne zbatim te lejes minerare nga gjate fazes se ndertimit, instalimit te pajisjeve dhe ne fazen e sshfrytezimit.

Objekti i gelqeroreve per te cilin hartohet studimi ndodhet ne territorin e Bashkise Elbasan njesia administrative Shushice, rrethi Elbasan. Zona ne studim ndodhet ne harten topografike planshteten K-34 -101-A-c, sh. 1 : 25000 e kufizuar me pikat 1,2,3, dhe 4 me kordinata si ne tabelen bashkangjitur.
Tabela e kordinatave Zona minerare 356/1 objekti Gjorma, Elbasn

Pikat	X	Y
1	45 61 000	44 18 250
2	45 62 000	44 18 250
3	45 62 000	44 19 250
4	45 61 000	44 19 250
	Siperfaqja	1.00km2



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE
DHE INDUSTRIE

Nr. 4576/2 ProL

Tiranë, më 27/07/2021

T.Ënda: Njoftim Fitues!

SHOQËRISË "VELLEZERIT HYSA" SH.P.K

Fshati "Banjë e Re", Njësia Administrative Klos, Cërrik, Elbasan

Nr.1 Referencës: Zona Minerare Nr. 356/1, për objektin Gjorma, Qarku Elbasan, lloji mineralit gëlqeror, veprimtaria shfrytëzimi, e miratuar në planin vjetor minerar të vitit 2012.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë lajmëron shoqërinë "Vellezerit Hysa" sh.p.k, me NUIS K12911201, me adresë: Fshati "Banjë e Re", Njësia Administrative Klos, Cërrik, Elbasan, se oferta e paraqitur më datë 11.05.2021, për përfundimin e të drejtës për aplikimin për leje minerare në zonën minerare nr. 356/1, për vlerën totale të investimit prej 208 166 667 [dyqind e tetë milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë] lekë dhe sasinë e prodhimit të mineralit gëlqeror 450 000 [katërqind e pesëdhjetë mijë] m³/vit, është pranuar si ofertë e suksesshme në procedurën e konkurrimit për të drejtën e aplikimit për leje minerare në zonën minerare konkurruese nr. 356/1, për objektin Gjorma, Qarku Elbasan. Lloji mineralit gëlqeror, veprimtaria shfrytëzimi, me kushtet që projekti i zhvillimit të veprimtarisë minerare që paraqitet me aplikimin në QKB duhet të përcaktojë:

• Prodhimi që mendohet të realizohet në zonën minerare	450 000 m ³ /vit
• Sasia e prodhimit që do të përpunohet	450 000 m ³ /vit
• Vlera e investimit që parashikohet për tu kryer	208 166 667 lekë
• Vlera e produkteve minerare	8 661 150 000 lekë
• Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR=...%)	49.48 %

Ofertuesi shoqëria "Vellezerit Hysa" sh.p.k kërkohet t'i paraqesë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Rr. "Abdi Toptani" Nr. 1 – Tiranë:

- Kopjen e vënies në dijëni për Formularin e Njoftimit, të nënshkruar.
- Në rast se tërhiqeni nga aplikimi për lejen minerare duhet të njoftoni me shkrim ju më vonë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë kalendarike nga data e nënshkrimit të këtij njoftimi.


KRYETARI I AUTORITETIT KONTRAKTUES


Belinda Balluku



Adresa: Rr. "Abdi Toptani", Nr. 1 Tiranë, Shqipëri. Web: <http://www.infrastruktura.gov.al>

Leja Minerare Nr...(zona356/1)




MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
 DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN E MINIERAVE DHE INDUSTRIË
 OBJEKTI "Gjorma", Qarku Elbasan

ia nr. **356/1**
 erali **Gëlqeror**
 i i lejes **Shfrytëzimi**
 rfaqja, km² **1.000**
 data **08.02.2021** firma



Kordinatat		
Pika	X	Y
1	4561000	4418250
2	4562000	4418250
3	4562000	4419250
4	4561000	4419250

117000 000000 4418000 000000 4419000 000000 4420000 000000 4421000 000000

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

a-Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit te shfrytezimit te mineralit gur gelqeror.

VNM nuk do te mbuloj cdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjetër eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrueshmërisë se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit te shfrytezimit te mineralit.
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT

a. Qellimi i projektit te propozuar

Qellimi i projektit te propozuar nga shoqeria “VELLEZERIT HYSA” shpk eshte shfrytezimi i gurit gelqerore me kariere me punime siperfaqesore , zona minerare nr. 356/1, per nxjerrjen e mineralit te gurit gelqeror qe sherben si lende e pare ne industrine e ndertimit.

Kjo zone eshte e preferuar per shfrytezimin e gurit gelqerore me kariere me punime siperfaqesore nga ana e shoqerise sepse ndodhet ne afersi te impiantit te qendrave te medha te banuara. Nga pikpamja gjeografike terreni ku ndodhet objekti per shfrytezim « guri gelqeror » eshte terren kodrinor-malor.

Persa i perket referencave per harta kadastrale pyjore keto do ti paraqiten Ministrise se Mjedisit pasi shoqeria pajiset me leje mjedisore dhe fillojne procedurat per heqjen nga fondi pyjor ne baze te vendimit nr.1374 date 10.10.2008 Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor, vendim nr.435 date 8.6.2016 Per disa ndryshime dhe

« VELLEZERIT HYSA »shpk

shtesa ne vendimin nr.1374 date 10.10.2008 te Keshillit te Ministrave “Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave, qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit Kullosor”, Vendim nr.1353 date 10.10.2008 Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses, mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kriterëve te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor, Vendim nr. 434 date 8.6.2016 Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr.1353 date 10.10.2008 te keshillit te ministrave Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses , mbajtjen dhe plotesimin e dokumentacionit teknik si dhe te kriterëve e te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor”.



Kjo zone eshte prone shteterore kullot, nuk ka objekte banimi, industriale dhe nuk gezon ndonje status te vecante. Objekti nuk eshte i lidhur me rrugen automobiliditike . Zona nuk ka ndonje perdorim te vecante , perdoret pjeserisht nga banoret e zones per kullote. Ne perfundim te aktivitetit kjo zone do te rehabilitohet dhe do ti kthehet funksionit te meparshem te saj dhe perdorimit nga banoret e zones.



Planimetria e vendodhjes se projektit , ku te pasqyrohen ne harte topografike kufijte e siperfaqes se tokes se kerkuar,te shoqeruar me koordinatat sipas sistemit GAUSS KRUGER, fotografi dhe te dhena per perdorimin eksiztues te siperfaqes se tokes qe do te perdoret perkohesisht apo perhere nga projekti gjate fazes se ndertimit apo instalimit te pajisjeve

Objekti i gelqeroreve per te cilin hartohet studimi ndodhet ne territorin e Bashkise Elbasan Administrativisht i perket ndarjes administrative te rrethit te Elbasanit. Zona ne studim ndodhet rreth 14 km larg qytetit te Elbasanit.

Koordinatat kufizuese te zones minerare sipas Njoftimit te Fituesit date 27.07.2021 nr.4576/2 prot leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise.

Koordinatat jane ne sistemin GAUSS KRUGER (Albanian 1986 /GAUSS –KRUGER Zone 4).

Pikat	X	Y
1	45 61 000	44 18 250
2	45 62 000	44 18 250
3	45 62 000	44 19 250
4	45 61 000	44 19 250
	Siperfaqja	1.00km ²



Ekonomia e zones dhe aktivitetet kryesore te saj.

« VELLEZERIT HYSA »shpk

Popullsia e zones merret kryesisht me bujqesi, blegtori, pemtari dhe nje pjese punon ne aktivitetet private industriale dhe te sherbimit qe jane ngritur ne kete zone.

Aktivitetet kryesore ekzistuese ne zone dhe per rreth saj jane :

- Veprimtari sherbimi, bar restorante, pika karburanti, servise, baxho prodhimi te produkteve nga qumeshti, etj.


Infrastruktura:

Rrjet rrugor ne zone mungon, nuk ka rruge automobilistike , fshatrat dhe banesat lidhen me rruge provizore te paasfaltuara te ndertuara nga vet komuniteti.

Skicat dhe planimetritet e objekteve te projektit dhe strukturave te projektit

Ne aktivitetin e projektuar do te behen ndertime te Reja te strukturave me themele, si objekte sherbimi e trajtimi, objekte industriale, si linje prodhimi inerte,etj.


Objektet e sherbimit te trajtimit te punonjesve, objektet industriale, infrastruktura rrugore linja e prodhimit te inerteve me thyerje fraksionim, linja e furenizimit me energji elektike, me uji per sherbimet



« VELLEZERIT HYSA »shpk

PROFILI I SHFRYTEZIMIT I - I NE GJENDJEN PERFUNDIMTARE

SH. 1 : 1000




Legjenda

Cr₂ Mineral Gelqeror

PROJEKTUES:	"STUDIO PROJEKT" SH.P.K	TIRANE
OBJEKTI:	STUDIMI TEKNIKO-EKONOMIK DHE PROJEKTI I SHFRYTEZIMIT TE VENDBURIMIT TE GURIT GELQEROR, OBJEKTI "GJORME", ZONA MINERARE NR. 356/1, QARKU ELEBASAN	
POROSITES:	"VELLEZERIT HYSA" shpk	
EMERTIMI I FLETES:	PROFILI I SHFRYTEZIMIT I - I NE GJENDJEN PERFUNDIMTARE	
GRUPI PROJEKTIMIT :		Nr.Lic.
INXHINIER MINIERE:	XHEVAJR DERMISHI	
INXHINIER GJEOLGJ:		
TOPOGRAF:	REDIAN LLAPUSHI	
GJEONXHINIER:	ERMIR DERMISHI	
Data:	Shkalla e printimit:	Emri i fletes:
Prill 2021	1 : 1000	0-06

PROFILI I SHFRYTEZIMIT II - II NE GJENDJEN PERFUNDIMTARE

SH. 1 : 1000




Legjenda

Cr₂ Mineral Gelqeror

PROJEKTUES:	"STUDIO PROJEKT" SH.P.K	TIRANE
OBJEKTI:	STUDIMI TEKNIKO-EKONOMIK DHE PROJEKTI I SHFRYTEZIMIT TE VENDBURIMIT TE GURIT GELQEROR, OBJEKTI "GJORME", ZONA MINERARE NR. 356/1, QARKU ELEBASAN	
POROSITES:	"VELLEZERIT HYSA" shpk	
EMERTIMI I FLETES:	PROFILI I SHFRYTEZIMIT II - II NE GJENDJEN PERFUNDIMTARE	
GRUPI PROJEKTIMIT :		Nr.Lic.
INXHINIER MINIERE:	XHEVAJR DERMISHI	
INXHINIER GJEOLGJ:		
TOPOGRAF:	REDIAN LLAPUSHI	
GJEONXHINIER:	ERMIR DERMISHI	
Data:	Shkalla e printimit:	Emri i fletes:
Prill 2021	1 : 1000	0-09

PROFILI I SHFRYTEZIMIT III - III NE GJENDJEN PERFUNDIMTARE

SH. 1 : 1000



EMERTIMI I SHIKALLES	KUOTA	SIPERFAQJA
S1	+335 + +345	170 m ²
S2	+325 + +335	407 m ²
S3	+315 + +325	711 m ²

Legjenda

Cr₂ Mineral Gelqeror

PROJEKTUES:	"STUDIO PROJEKT" SH.P.K	TIRANE 2021
OBJEKTI:	STUDIMI TEKNIKO-EKONOMIK DHE PROJEKTI I SHFRYTEZIMIT TE VENDBURIMIT TE GURIT GELQEROR, OBJEKTI "GJORME", ZONA MINERARE NR. 356/1, QARKU ELEBASAN	
POROSITES:	"VELLEZERIT HYSA" shpk	
EMERTIMI I FLETES:	PROFILI I SHFRYTEZIMIT III - III NE GJENDJEN PERFUNDIMTARE	
GRUPI PROJEKTIMIT :		Nr.Liq.
INXHINIER MINIERE:	XHEVAIR DERMISHI	
INXHINIER GJEOLGJ		
TOPOGRAF:	REDIAN LLAPUSHI	
GJEOINXHINIER:	ERMIR DERMISHI	
Data:	Shkalla e pririmit:	Emri i fletes:
Prill 2021	1 : 1000	0-12

PERSHKRIM I PROCESIT NDERTIMORE DHE TEKNOLLOJIKE, PERFSHIRE KAPACITETET PRODHUESE/ PERPUNUESE , SASITE E LENDEVE TE PARA DHE PRODUKTET PERFUNDIMTARE TE PROJEKTIT.

Ne fazn e pare ne objektin e zones minerare Nr 356/1, do te hapet nje rruge e Re, me gjatesi 2500m, qe do te lidh aktivitetin minerar me rrugen kombetare Elbasan – Tirane prane fshatit Dopaj . Rruga e Re do te ndertohet me standarte bashkekohore.

Rruga do te hapet me makineri e paisje me eskavator, me matrapik te vendosur ne krahu e eskavatorit, me gjeresi 6m dhe pjerresi maksimale deri 8% do te jet e asfaltuar . Me projekt nuk do te ndertohen objektet e sherbimit dhe linja e prodhimit te inerteve me thyerje fraksionim .

ELEMENTET KRYESORE TE SEGMENTEVE TE RRUGES .

- Gjeresia e rruges 6 m
- Gjatesia e rruges 2500m.
- Pjerresia e rruges mesatare 6%
- Volumi shkembit per hapjen e rruges 4500m³
- Shtrim rruge me ballaster, stabilizant 24cm dhe granil 12cm 5400m³

Anes rruges prane skarpates do te hapet kanal me gjatesi 800m per drejtimin e ujrave atmosferike

Dimensionet e kanalit do te jene:

- Baza e sipërme 40cm
- Baza e poshteme 20cm
- Thellesia e kanalit 40cm

Volume shkembit te krijuar nga hapja e kanalit eshte:

$$V = (0.4 + 0.2) : 2 \times 0.4 \times 2500 = 300m^3$$

Rruga do të ndërtohet në formë kurrizore me pjerresi nga aksi në drejtim të kanaleve 1.2-1.5% për kullimin e ujrave.

Pas hapjes të vendburimit dhe përgatitjes së sheshit të shkallës së parë, në zbatim të projektit, shfrytëzimi i gurit gelqeror do të bëhet me karriere.

Teknologjia e shfrytëzimit të mineralit ndërtime gurit gelqeror me karriere është e thjeshtë dhe konsiston si vijon:

- Coptimin e gurit gelqeror, me matrapik, ose me lende plasese të vendosur në bira sonde.
- Narkimin e gurit gelqeror në sheshet e shkalleve do të bëhet me eskavator.
- Transporti i gurit gelaqeror nga fronti i shfrytëzimit deri në linjen e prodhimit të inerteve me thyerje fraksionimit do të bëhet me kamione tip DAMBER me kapacitet 24m³ ndërsa inertet e prodhuara do të transportohet tek konsumatorët me kamione tipitrajler.

Coptimi i gurit gelqeror në objektin e projektuar për hapjen e rruges automobilistike deri në kuotën e shkallës së parë, do të bëhet me matrapik të vendosur në krahun e eskavatorit ose me lende plasese të vendosur në bira sonde, ndërsa coptimi i gurit gelqeror në shkallët e karrierës do të bëhet me lende plasese të vendosur në bira sonde.

Sonda do të vendoset në sheshin e sipër të shkallës.

MENYRAT E RREZIMIT TË GURIT GELQEROR NË SHKALLET E KARRIERES

Depozitimet e fresketa të gurit gelqeror janë të forta prandaj do të shkrirohen me lende plasese të vendosura në bira sonde.

Coptimi i shkëmbit në karriere është projektuar të bëhet me këto metoda

1 - Me lende plasese të vendosur në bira sonde.

2 -Me matrapik të vendosur në eskavator.

Coptimi me matrapik do të përdoret kryesisht për ndërtime e rruges së hapjes së karrierës, punimeve përgatitore,shesheve të vendosjes së sondës së shpimit dhe ricoptimit të copave të mëdha të dala nga shpërthimi.

COPTIMI I GURIT GELQEROR NË SHKALLET E KARJERES ME LENDE PLASESE TË VENDOSUR NË BIRAT SONDE

Punimet e projektuara të coptimit të gurit gelqeror në shkallët e karrierës me bira të thella sonde siguron :

-Prodhim të lartë në vartësi të kërkesave të tregut.

-Coptimin e tij me përmasat e kërkuara.

-Punë normale dhe komode brenda rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes në punë.

Për shpimin e birave në sheshet e shkalleve të karrierës projektuar për shfrytëzim me rrezistencë në shtypje mbi 800kg/cm², përdoret makina shpimi vet – lëvizëse mbi zinxhira të prodhuara nga uzinat « TAMRROK » ose“ATLAS COPCO”, me instrument çpimi në fundin e bires, me koke çpimi 89mm. Tipet e sondave që rekomandojmë shpajnë bira me diametër 88.9mm-220mm, me thellesi maksimale 30 m, kënd çpimi mbi 135⁰, me gjatësi shtange çpimi 4m, diametër shtange 76mm, montim cmontim, ndërrim në mënyrë të mekanizuar të shtangave, me kapje të pluhurit me sistem respiratori

-Sasia e ajrit të prodhuar nga kompresori

21 m³/minut

-Presioni ajrit

14 bar

- Shpejtësi shpimi

0.3ml/minut

ELEMENTET E SISTEMIT TE SHFRYTEZIMIT QE DO TE PERDOREN JANE:

- Shfrytezim me karjere	me shkalle horizontale
-Gjeresia e sheshit te punes ne shkallet e karrieres minimumi	12m
-Gjeresia e sheshit te punes ne shkallet e karrieres ne gjendjen perfundimtare	4m
-Larteia e shkalles	12m.
-Numri i shkalleve ne pune njekohesisht mbi	4 shkalle.
-Kendi i skarpates se shkalles	65-70°
-Diametri bires	89.9mm deri 127.0mm
-Largaesia e birave ne rresht	3,5m-4.5m
-Largesia midis rreshtave	3 m -4m
-Konsumi i lendes plasese do te jete	0.25kgm ³ - 0.3kg/m ³
-Ngarkimi i gurit gelqeror ne sheshin e shkalles se shfrytezimit	do te behet me eskavator te vendosur ne sheshin e poshtem te shkalles
-Rrezimi i gurit gelqeror ne frontin e punes do behet me lende plasese te vendosur ne bira sonde	
-Transporti i gurit gelqeror nga fronti punes do te behet me kamion deri ne destinacion.	
-Kapaciteti prodhues per 25 vjet do te jete	11 250 000 m ³
-Koha e aktivitetit	25 vjete
-Prodhimi vjetot	450 000m ³ /vit
- Prodhimi mujor do te jete	37 500m ³ /muaj
- Prodhimi ditor do te jete	1875m ³ /dite
- Koha e punes ne/24ore, me nji ose dy turne nga 8ore/turni	



PERSHKRIMI I PROCESIT TEKNOLOGJIK I IMPJANTIT TE FRAKSIONIMIT TE PRODHIMIT TE INERTEVE

Minerali ndertimor “gur gelqeror” i prodhar ne karriere do te perdoret per prodhim inertesh, lende e pare per industrine e ndertimit. Subjekti ne zbatim te projektit ne territorin e karrieres do te ndertoj linjen e thyerje fraksionimit te gurit gelqeror per prodhim inertesh , si: rere fino, Rere suvatimi, rere betoni, granil “1”, Granil “2”, cakull, stabilizant, etj.

LENDET E PARA QE DO TE PRODHOHET NE IMPJANTIN E THYERJE - FRAKSIONIMIT TE GURIT GELQEROR JANE:

- a-Guri gelqeror bruto ne sasine 450 000m³/vit
- b-Inete nga perpunimi ne impjantin e thyerje fraksionimit te gurit gelqeror si:
- c- Rere suvatimi dhe betoni 0mm-4mm dhe 0mm-5mm =162000m³/vit
- d-Granil “1“ 5mm-12mm =121 500m³/vit
- e-Granil “2“ 12mm -24mm =121 500m³/vit
- m-Stabilizan 0mm-20mm = 45000m³/vit

« VELLEZERIT HYSA »shpk



Pershkrimi skemes teknologjike te impjantit

Procesi teknologjik do te kryet sipas skemes klasike te prodhimit te inerteve me baze gurin gelqeror. Impjanti thyerje fraksionimit te gurit gelqeror me kapacitet perpunimi 200-250m³ gur gelqeror ne ore per prodhimin e inerteve si fino, rere suvatimi, rere betoni, granile, stabilizant,etj; perbehet nga keto linja kryesore:

Impjanti thyerjes se shkalles se pare

Guri gelqeror i prodhuar ne kariere transportohet me kamiona dhe shkarkohet ne bunkerin metalik te frantojes, trasportohet nga ushqyesi tek pastruesi ne te that, prej andej hyn ne frantoje dhe coptohet me dimensione nga 0-1200mm

Sheshi shkarkimit ndertohet ne kuoten e bunkereve

Lenda e pare guri gelqeror shkarkohet ne bunkerat e linjes thyerje fraksionimit te prodhimit te inerteve.

Pershkrimi skemes teknologjike te impjantit

Procesi teknologjik do te kryet sipas skemes klasike te prodhimit te inerteve me baze gurin gelqeror. Ne impjantin e thyerje fraksionimit te gurit gelqeror do te prodhohen inerte si fino, rere suvatimi, rere betoni, granile, stabilizant, etj, ne vartesi te kerkesave te tregut. Impjanti i thyerje fraksionimit te gurit gelqeror perbehet nga keto linja kryesore:

Impjanti thyerjes se shkalles se pare

Guri gelqeror i prodhuar ne kariere transportohet me kamiona dhe shkarkohet ne bunkerin metalik te frantojes, trasportohet nga ushqyesi tek pastruesi ne te that, prej andej hyn ne frantoje dhe coptohet me dimensione nga 0-120mm

Sheshi shkarkimit ndertohet ne kuoten e bunkereve

Lenda e pare guri gelqeror me madhesi copash 0-1200mm shkarkohet ne bunkerat e linjes thyerje fraksionimit te prodhimit te inerteve.

Bunkerit lendes se pare te gurit gelqeror perbehet nga keto pisje:

-Kazani metalik me kapacitet 50m³

-Ushqyesi frantojes qe vihet ne levizje horizontale nga nje system bjelle manivele me elektromotor me fuqi 21kw

-Vibratori pastrimit net e that te gurit gelqeror qe vihet ne levizje me elektromotor me fuqi 11kw.

-Frantoja e thyerjes se gurit gelqeror me cekic te vendosur ne aks horizontalisht, me dimensione te grykes se frantojes 1.2m x 2m dhe qe vihet ne pune nga nje electromotor me fuqi 135kw me rripa trasmesioni trapezoidal qe levizin pulexhon active dhe passive.

Trasportjeri nr.1

Fraksioni gurit gelqeror i thyer ne frantoje me dimension 0-120mm, nepermjet hinkes se frantojes bie ne trasportjerin nr. 1.

Tansportjeri ka keto dimensione, gjatesi 24m, gjeresi 1.2m, trashesi te shiritit 10mm. Trasportjeri vihet ne levizje me electromotor 18kw

Sistemi sitave nr. 1

Sistemi sitave nr. 1 perbehet nga tre kate dhe fraksionon 4 fraksione, si:

-Rere betoni	0-5mm
-Granil "1"	5-12mm
-Granil "2"	12-30mm

-Cakell

30-120mm

Fraksionet si me siper, shkarkohen respektivisht ne trasportieret nr 2,3,4 dhe 5.

Gjatesia e trasportierve 2,3,4 eshte 20m, gjeresi 60mm, trashesi 6mm. dhe vihen ne pune nga elektromotore me fuqi 7kw

Fraksioni me dimension 30-120mm nga me ane te trasportjerit 5 shkarkohet ne mullirin e thyerjes te shkalles se dyte.

Mulliri thyerjes se shkalles se dyte

Mulliri thyerjes se shkalles se dyte eshte kontruksion mekanik me hapsire pune 104cm, me lama te vendosura ne distance 8mm. thyrja e gurit gelqeror behet me cekica, te cilet vihen ne levizje nga nje electromotor me fuqi 135kw me 1200 rrotullime/minute.

Guri gelqeror me fraksion 30-120mm ne thyerjen e shkalles se dyte coptohet ne madhesin 0-5mm.

Fraksioni 0-5mm nga hinka e bunkerit bie ne trasportierin 6 dhe prej andej dergohet ne sistemin e sitave nr. 2 me dy kate.

Ndersa pluhurat qe dalin ne hinken e mullirit kapen me ane te sistemit te thithjes se pluhurave dhe dergohen aspirator. (Shif foton si me poshte)

Sistemi kapjes se pluhurit.

Linja e prodhimit te inerteve me thyerje fraksionim ne te thate eshte me teknologji moderne.

Te gjitha paisjet jane te hermetizuara dhe pluhurat qe krijohen gjate thyerjes ne shkallen e pare, te dyte te coptimit, sisten vibruese etj thithen me ane te ventilatorit qendror dergohen ne aspiratorin tip SCF 12 NO12C, ME KAPACITET 58 200 m3/ore. Thithja e pluhurit behet tek mulliri me cekica, sistemin e sitisjes me vibrim dhe mulliri thyerjes se shkalles se dyte.

Mbi tubin e shkarkimit te ajrit te filtruar eshte vendosur nje sistem dushi uji qe furnizohet nga pompa me uji te riciklueshe te vaskes se dekantimit.

Ajri pas ketij procesi nuk do te permbaj pluhur.



Paneli komandimit te impjantit

Paneli vendoset prane bunkerit te lendes se pare ne pozicion dominues qe te ket pamje vizuale mbi te gjith linjen e prodhimit te inerteve.

Panelisti pasi sigurohet se prane mekanizimeve qe jane ne levizje nuk ka punonjes e ve ate ne pune. Eshte rregull qe leshimi impjantit ne pune fillon nga paisjet fundore deri tek ushqyesi frantojes se thyerjes se gurit gelqeror. Ndersa ndalimi linjes behet ne te kunderten, ndalohet ushqimi frantoje, pas tij sistemi pastrimit, frantoja, trasportjeri deri tek trasportjeret fundore.

Ngarkimi inerteve ne sheshin e prodhimit

Ngarkimi inerteve te prodhuara ne impjantin e thyerje fraksionimit te gurit gelqeror do te behet me fadrom ma kapacitet te koves 4m3.




Shkarkimet e ujerave te vaskave te dekantimit

Ne procese teknologjike te shfrytezimit te gurit gelqerore me kariere nuk do te perdoret uji. Nje nder arsyet eshte se guri gelqeror me prezence uji ndotet sepse perzihet me dherat dhe e ben te papranueshme per perdorim. Uji do perdoret per lagien e territorit per paksimin e pluhurave ne stinen e thate , gjate procesit te nxjerrjes se gurit gelqeror dhe do sigurohet permes depozitave nga shoqeria.

Ujerat e ndotura nga pluhurat e krijuara nga shfrytezimi i gurit gelqeror do te depozitohen ne vaskat e ndertuara ne sheshin e karieres . Praktikisht do te ndertohen dy vaska me keto parametra: gjatesi 6m, gjeresi 3m dhe thellesi 2m. Uji i perdorur do te shkarkohet ne nje vaske dhe pasi te dekantohet masa e ngurte ujrave kalon ne vasken tjeter. Ujerat largohen nga vaska pasi te jene ngurtesuar mbetjet e ngurta dhe depozitohen ne sheshin e caktuar nga pushteti vendor ose ne sheshin e karieres ne nje zone te percaktuar per tu perdorur gjate fazes se rehabilitimit. Vaskat rrethohen me lartesi deri 2m me rrjet metalike te qendrueshme per tu mbrojtur nga renia e njerzve ne to dhe per menjanim aksidentet ne pune. Ujerat e pastra pas vaskave do te riperdoren ose do te shkarkohen ne mjedisin ujrave prites.

SKICA E VASKAVE TE DEPOZITIMIT TE LLUMRAVE



Gjithashtu mbetjet e krijuara ne kariere nga veprimtaria humane e punonjesve ose nga proceset e punes do te trasportohen ne sheshin e depozitimit te miratuar nga pushteti vendor

3. NJE PERSHKRIM I ANALIZIMIT TE ALTERNATIVEVE TE MUNDSHME PER ZBATIMIN E PROJEKTIT OSE KOMPONENTEVE TE VECANTA TE TIJ (SI AKSESI RRUGOR, ADMINISTRIMI I MBETJEVE DHE UJRAVE TE NDOTURA , LLOJET E LENDEVE DJEGESE , VENDODHJA E PROJEKTIT ETJ) SI DHE SQARIMI I ARSYEVE KRYESORE PER ALTERNIVEN E PROPOZUAR , DUKE MARR PARASYSH NDIKIMET NE MJEDIS TE SELICES ALTERNATIVE , SI DHE NE RAST SE KA MENDIMET DHE SUGJERIMET E INSTITUCIONEVE PERGJEGJESE QE MBULOJNE FUSHEN E ZBATIMIT TE PROJEKTIT.

Theksojme per organet vendim marrese, se mundesia e alternativave te marra ne konsiderat per perzgjedhjen e vendodhjes se projektit nga subjektet minerare ne teresi jane ne nivelin zero per keto arsye:

- Zona minerare dhe objekti percaktohet nga MIE me propozim te AKBN-se dhe shpallet ne planin tre vjecar dhe nji vjecar te Ministrise.
- Investitoret qe kryejne aktivite minerare jane para nje fakti te kryer per pjesmarrje ne tender te zonave minerare te shpallura per konkurim.

Subjekti "VELLEZERIT HYSA"shpk ka marre pjese ne konkurimin e zhvilluar ne MIE per perfitimin e te drejtes per aplikimin ne QKB per Leje minerare shfrytezimi per zonen minerare nr. 356/1dhe ne daten 27/17/2021 me shkresen me Nr 4576/2 Prot eshte njoftuar nga MIE si fitues i ketij konkurimi dhe ka fituar te drejten e pergatitjes se dokumentave perkatese per pajisjen me leje minerare shfrytezimi ne zonen konkuruese Nr.356/1, Objekti Gjorma Eshte zgjedhur kjo zone duke qen se konsiderohet si nje vendburim me rezerva te konsiderueshme te mineralit te gurit gelqeror ne baze te studimeve te bera.

Per shfrytezimin e ketij vendburimi, pjese e procedures eshte edhe aplikimi prane Ministrise se Mjedisit per Proceduren e thelluar te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (*aktiviteti perfshihet ne Shtojcen I Kodi 19*).

Persa i perket aksesit rrugor Objekti lidhet me rrugen automobilistike nacionale Tirane-Elbasan. Zona ne studim ndodhet rreth 14km larg qytetit te Elbasanit. Per hapjen e objektit do te hapet nje rruge brenda siperfaqes se karieres per te shkuar ne piken me te larte per te filluar punimet e shfrytezimit.

Zhvillimi i aktivitetit te shfrytezimit te gurit gelqeror nuk krijon mbetje qe ndikojn negativisht ne mjedis, nuk krijojn ujera te ndotura sepse nuk perdoret uje per procese teknologjike dhe nuk perdor lende djegese.

4. NJE PERSHKRIM TE GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TE MJEDISIT QE MUND TE NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR DUKE PERFSHIRE

Pershkrim te karakteristikave fizike te zones se projektit

- Pershkrim i faktoreve klimatike

Pozita gjeografike, konfiguracioni i relievit, lartësia mbi nivelin e detit dhe largësia nga deti Adriatik ka mundësuar natyrën mesdhetare te klimës e cila duket ne dimrin e bute e te lagësht dhe ne vëren e nxehte e te thate. Klima e fushegropes se Elbasanit eshte me ngrohte se e gropave te tjera. Ne te njejten kohe duhet theksuar se dimri ne pergjithesi eshte i bute. Nder faktoret local qe luajne rol te madh ne vecorite klimatike te kesaj fushegropes ka rendesi te permendet si z lugine.

Temperature mesatare vjetore eshte 15.8 ° C , e korrikut 23.6 ° C dhe e janarit 6.6 ° C . amplitude e temperatures mesatare vjetore eshte 21 ° C. ngricat jane dukuri e zakonshme. Reshjet jane te pakta. Mesatarja vjetore arrin 889.1 mm. stina me e lagesht eshte dimri me 310.4 mm. nje pjese e reshjeve bie ne formen e debores.

- Pershkrim gjeomorfologjik dhe i sizmicitetit i zones se projektit

Per shkak te evolucionit te nderlikuar gjeologjik dhe paleogeologjik te territorit te Shqiperise , vecorive te zhvillimit morfotektonik e morfoklimatik, shumellojshmerise se shkembinjve qe

ndertojne territorin, faktoreve te shume ekzogjene dhe inten sitteit te larte te tyre , relievi i Shqiperise dallohet per nje larmi shume te amdhe formash si ne drejtimin horizontal , ashtu edhe ne ate vertikal .

Zona Dopaj perfaqesohet nga shkembijnt sedimentare te cilet perhapen ne nje siperfaqe te gjere

Kjo zone shkeputjesh paraqitet me nivele te ndryshme te aktivitetit sizmik. Analiza e fushes makrosizmike te termeteve qe kane rene ne shtrirje te kesaj zone tregon se buzet e ultesirave grabenore te permendura me siper paraqiten me akivitet sizmik. Planet e thyerjeve te percaktuara nga kjo analize perputhen si gjeometri dhe si kinematike me thyerjet gjatesore me drejtim VP-JL te ketyre ultesirave, te cilat karakterizohen nga nje regjim sforcimesh te terheqjes me drejtim te pergjithshem VL-JP . Nga analiza sizmotektonike eshte arritur ne perfundim se zona e thyerjeve sizmoaktive Shkoder-Mat- Tirane-Elbasan mund te gjeneroje termete me magnitude maksimale deri $M_s=7.0$ ne segmentin e Shkodres dhe $M_s= 5.0-5.5$

-Perskrim i gjeologjise dhe tokes ne zonen e projektit

Ne zonen e marre per studim depozitimet sedimentare perfaqesohet nga shkembijnt gelqerore te cilet perhapen ne pjesen lindore dhe perendimore dhe depozitime argjila e alevrolite te cilat mbulojne zonen mbi te cilat jane vendosur depozitimet e gelqerori.

-Perskrim i ujerave siperfaqesore dhe nentokesore ne zonen e projektit

Nga pikepamja hidrografike zona e marre per studim ka kushte te mira per behet nga terren ne lindje shpat me pjerresi te bute ne jug dhe me renie vertikale. Rrjedhja siperfaqesore e ujerave derdhet ne perroin e Gjormit. Rrjedhjet nentokesore jane karakteristike per depozitimet e gelqeroreve qe filtrojne ne kolektoret e permendur me larte. Ujerat nentoksore jane te pakta e me prurje te vogel.

Perskrim i biodiversitetit ne zonen e projektit

- Perskrim te habitateve kryesore ne zonen e projektit si dhe harta ilustruese

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen Mbulesa bimore ne zonen ku do te shfrytezohet perfaqesohet nga shkurret dhe vende-vende ka shfaqje te gelqerorit. Ne zone rriten kryesisht shkoza, bushi, dellinja , pak shqope si dhe perfaqesues te familjes graminore

PERSHKRIM I SHKURTER I MBOLESES BIMORE TE SIPERFAQES KU PROPOZOHE TE ZBATOHE PROJENTI, SHOQUERUAR ME FOTO

Objekti i gurit gelqerore projektuar per shfrytezim ndodhet ne territorin e fshatit Gjorma, Rrethi Elbasan.

Ne pjesen veriore ndodhet Fshati Mollagjesh, ne nje distance rreth 1250 m larg e ne vije ajrore.

Ne lindje kufizohet nga kullota zona malore te pa banuara.

Ne jug-lindje kufizohet me fshatin Bixelleja ne largesi mbi 1500m ndersa ne jug per rreth 3000m zona nuk eshte e banushme territor shkemboor, kryesisht kullota.

Ne pjesen perendimore kufizohet me fshatin Gjora ne largesi mbi 550m, me fshatin Shengjin rreth 1000m dhe fshatin Dopaj ne largesi 1250m dhe me tej me autostraden Tirane – Elbasan ne distance 2500m

Zona nga ana administrative ben pjese ne rrethin Elbasan dhe ndodhet ne very lindje te qytetit te Elbasanit. Rajoni i studjuar eshte zone kodrinore. Relievi eshte tipik malor me maja te larta. Territori ne studim nderpritet nga perrenj te shumte siperfaqsor me rrjedhje tere vitin por dhe sezonal.

Relievi paraqitet mjaft i diferencuar ne forme tipike te relievit me brazda. Karakteristike jane edhe relievet kodrinor paramalor e deri e deri ne malor, majat me kreshte dhe me shpate, me pjerresi te forta dhe te shkaterruara nga erozioni.

Fshatrat kryesore qe perfshihen ne kete zone jane Firas, Repeni, Funari, Gjorma, Braneshi, Bixelionja, Precie, e Poshtme, Precie e Siperme, Mamel, Shingjin, Iapaj , etj.



Per nga origjina , perberja dhe veçorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket veçorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percaktuar edhe veçorite origjinale te flores se Shqiperise.

E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet veçorive të evolucionit paleogeografik të Shqipërisë dhe sidomos larmisë së madhe të klimës, copetimit të theksuar të relievit dhe formave të shumëllojshme të tij, formacioneve të shumta shkëmbore (karbonatike, magmatike, terrigjene) etj.

Nga ana e reljevit përfaqëson në vetvete një pllajë kodrinore të vëluar që dallohet qartë në mjedisin që e rrethon. Format kryesore të reljevit të kësaj janë malet dhe gropat që ndryshojnë mjaftë nga reljevi për rreth. Kodrat dallojnë për formën e rrumbullakosur dhe shpatet të thepisura . Në ato sektor kur kemi dalje të gelqeroreve kemi pjerresë të shpatëve shumë të madhe. Në këto zone përhapje shumë të gjera kanë format negative të reljevit duke i dhënë pamjen e vëluar të luginës. Origjina e tyre në të shumtën e rasteve është tektonike karstike. Reljevi eroziv është zhvilluar fuqishëm Ky reljev përbehet nga rrjeti i luginave dhe brazdave të perrenjeve dhe rrekeve me dendësi të vogël.

Bimësia dhe Tipet e Vegjetacionit

Mbulesa bimore e zonës si dhe në afërsi të saj është e pasur me bimesë, si në lloje dhe në shtrirje.

Takohen vende me mikroklime të bute ku rriten drurë me gjelberim të përherëshëm , si marea ,shqopa, xina, perralli , dellinja, ilqe, mbreti, frasheri, shkoza, gjeneshtra etj. Gjithashtu takohen edhe territore me mikroklime malore të ashpër e malore, ku rriten e zhvillohen pyjet flete gjere e halore. Si rrjedhojë mbulesa bimore përbehet nga dy grupe kryesore, që dallohen mirë nga njëri tjetri.

Bimesia me mbizotërim të elementeve floristike mes Evropian dhe bimesia e tipit mesdhetar e cila me ndërprerje depërton nëpërmjet luginave . Ky grup bimesie gjendet në shpatet me drejtim perëndimor dhe jugperëndimor dhe përfaqësohet kryesisht nga shkurre mesdhetare të tipit të makjeve.

Bimesia është e përhapur në kate por kufiri i tyre është i vështirë të dallohet, si në drejtim vertikal dhe në atë horizontal. Fillon me brezin e shkurreve , vazhdon me atë të dushkut , pyjet gëthore e halore. Në katin e shkurreve vërejmë një formacion të brezit bimor të pyjeve të perziera.

Hpesirat me të mëdha mbulohen nga shkurret e tipit mesdhetar me gjelberim të përherëshëm e gjethë renes, ato takohen në lartësi 100-800m . Kryesisht mbulesa bimore dominohet nga pyje cunqishte kryesisht të lisit dhe shkurret, të cilat realizojnë një mbulesë të mirë të sipërfaqes së tokës. Nga shkurret si nënpyll takojmë: Juniperus communis L, Vaccinium myrtillus L, Sorbus graeca Kotsechy, Daphne oleoides skreb , Salix retusa , etj.

Flora barishtore e këtij tip pylli është e pasur me lloje. Kështu mund të përmendim: Genista hassertiana K, Richter, Sederitis raeseri Bser Melder, Forsythia europea Deg. et Bald, arastata Bornmulluera baldacci Heywood, Asperula areolata, etj. Flora barishtore dallohet për ekzistencën e lartë të llojeve endemike , subendemike dhe ballkanike

Flora e dushkajës përhere të blerte

Kjo florë është karakteristike për pyjet me Quercus ilex (Ilqe), të cilat janë të përhapura në këto zone. Kati i shkurreve të këtij tip bimesie është i pasur si në lloje por dhe në zhvillim të mirë. Llojet kryesore janë:

Xina (Pistacia lentiscus)

Arbutus unedo (Mare); Rosa sempervirens (Balkroka); Cistus inc anus (Menishtja e pushte)



Shqopa (erika arborea)

shkurreza ose shkurre perherblerta. Gjethet qerthullore, vizake. Lulet 4- pjeseshe. Nenpet;lat te lira, te gjelbra ose si ne ngjyre trendafili, me te shkurtra se kurora. Kurora cilindrike ose kambanore, me vrihuj me te shkurter ose te barabarte me gypin, e qendryseshme ne fryt.

Dellinje (juniperus)

Shkurre ose drure monoike ose dioike, gjethet te qendrueshme, halore ose mellugore, te perkunderta ose ne qethuj nga tre. Lulesas mashkull skajore ose sqetullore, vezake. Bocezat sqetullore ose skajore, piqen vitin e pare, te dytin, ose te tretin, rruzullore ose vezengjashme, mellugat mishtake, te ngjitura ndermjet tyre. Rritet ne zone me pak lageshti, frutet e saj perdoren kryesisht ne industrine mjekesore dhe pijeve alkalike.

Shkoze (carpinus)

Drure ose shkurre me lekure te lemuar te perhime. Sythat majemprehte me melluga te hsumta. Gjethet ne kohen e lulezimit ne zhvillimin e siper. Fryti me peshtjelle te vrigulluar ose te dhembezuar. Gjethet e saj jane ushqim kryesor per blegtorine.



Dushk (quercus)

Drure , rrale shkurre. Druret me palce yndyore peskendeshe. Sythet vezengjashem , gjethet te vrigulluara ose te dhembezuara, rrale te plota , renese ose te perhereblerta. Cdo lule rrethohet nga nje peshtjelle qe drunjezohet dhe shoqeron lendet. Dushku gjendet ne disa forma si dushk, lis, qarr etj , ka perdorim gjethet e tyre, lendet kryesisht ushqim per blegtorine, gjithashtu perdoret edhe per ngrohje.

Bimesia barishtore ne kete tip vegjetacioni perfaqsohet nga llojet: Viola alba Bess, Cyclamen hederifolium Ait, Dactylis glomarata, Linum bienne Miller, etj.

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet më me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithe rruzullin tokesor. Ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejne bazat per ekzistencen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit.

Per shkak te mbizoterimit te relievit kryesisht malor, qe kushtezon ndryshime te dukshme te klimes dhe te faktoreve te tjere, bimesia eshte e shkallezuar ne drejtim vertical

Pjesen e sipërme te brezit te shkurreve mesdhetare e zene shkurret qe i rrezojne gjethet gjate stines se dimrit si psh shkoza, frasheri, dushku, lisi, qarri, lojthata, ljthia, mulleza, etj.

Mbulesa bimore ne objektin Gjorma, projektuar per shfrytezim me karriere te mineralit ndertimor gur gelqeror si dhe zona per rreth te saj eshte e rrale , ku perfaqsohet nga shkurret mesdhetare.

Ne kete territor rriten kryesisht shkoza, dellinja, frasheri, lojthata, mareja, shqopa, gjeneshter, bime kulperi zvarranike, bime barishtore nji dhe shume vjecare si dhe perfaqesues te familjes graminore.

Shkurret dhe druret jane pjese e rendesishme e mbuleses bimore , jo vetem per evoluimin e peizazhit por edhe per arsyen sepse ato jane percaktuese per mbrojtjen nga erozioni.



Tokat

Tokat jane disa Llojesh:

- a- Te kafenjta malore,
- b- b- Te murme pyjore dhe livadhore.

Tokat jane formuar mbi shkembinjte karbonatike me mbulese pyjore te varfer dhe ne kushtet e nje klime me dimer te ftohte dhe me vere te fresket. Kane drenazhim te mire dhe jane te pasur ne carbonate. Si shkembinj amnore sherbejne magmatiket dhe pjeserisht terregjenet.

Klima e rajonit ne studim karakterizohet nga dimer I ftohte dhe vere e fresket.

Nga ana e reljevit, zona perfaqeson ne vetvete nje pllaje malore

NDERTIMI GJEOLGJIK I VENDBURIMIT

Depozitimet e Kretakut te Siperme Cr₂

– Gelqerore pelitomorf me globotrunkana, gelqerore coprizore

Depozitimet e Kretakut te Sipoerm te zones Kruja, takohen ne pjesen jug-perendimore te planshetit ne objekti. Jane depozitimet me te vjetra qe zbulohen ne siperfaqe ne zonen e krujes. Keto depozitime karakterizohen nga ndryshime te theksuara faciale. Nga studimi i mikrofacieve rezulton qe ne pjesen verilindore te zones Kruja ne nenzonen e Dajtit ku perfshihet struktura e Makareshit , Dajtit, Letanit . Gjithashtu ato jane takuar me puse kerkimi edhe nen depozitimet molasike te depresionit Tirane –Ishem. Ne strukturat e nenzones se Dajtit, pjesa e poshtme e prerjes perfaqsohet nga dolomite me nderthurje gelqerorësh dolomite qe permbajne ne disa shtresa dhe rudiste. Me siper prerja prediminohet nga gelqerore dolomitik, me nderthurje me te rralla dolomitësh masiv. Ne prerjet me te siperme takohen dolomote me nderthurje gelqerorësh bioklastike shtresetrashe.

Ndermjete dolomiteve dhe gelqeroreve dolomitik ne disa prerje (Tujan, Vaje, etj) takohen shiste te holla bituminoze.

Trashesia e Kretakut te Siperme jo per kete rajon luhetet nga 1200m ne Terkuze dhe 1400m ne prerjen e Zezes

Depozitimet e Kretakut te Sipoerm perfaqsohen nga gelqerore biomikritike e gelqerore argjilo-mergelore qe permbajne forominifere planktonike, me nderthurje te gelqeroreve turbidistike, si dhe ndershtresa e linza silicoresh. Per tu theksuar eshte fakti se ne pjesen me te siperme te prerjes karbonatike takohen shtresa te holla argjilash mergelore ngjyre te gjelber te celet, me nuanca te kuqerremta. Trashesia e prerjes se gelqeroreve eshte 300m

-Paleocen Pg₁

Keto depozitime i takojne nenzones Krasta. Ne planshetin e marre ne studim kane perhapje te gjere dhe takohen ne Shingjin i Madh, Ballgjin, Lukaxhi, Benaj, Xibrake , etj. Perfaqsojne pjesen e siperme te “flishit te ri”. Kufiri i poshtem i ketyre depozitimeve trasohet me zhdukjen e gjinise Globotruncana dhe fillimin e kompleksit karakteristik te Matrihtianit.

Litologjikisht keto depozitime jane shume te ngjashme me ato te Matrihtianit te Siperme. Ato perfaqsohen nga flish e flishoide , kryesisht ranor-alevrolitor te allternuar me ranore shtrese trashe deri masive, horizonte vithesese e konglomerate

-Eocen Pg₂

Keto depozitime i takojne te nenzones Krasta dhe zones Kruja.

Depozitimet Eocenike te nenzones Krasta takohen ne jug te planshetit te Xibrakes dhe midis fshatit Labinot Mal dhe Godolesh si dhe ne ekstremin verilindor te planshetes ku jane pjese Eocenit te rajonit te Okshtunit. Ne rajonin e Okshtunit ne depozitimet Eocenike diferencohen dy pako litologjike.

Subjekti “VELLEZERIT HYSA” shpk

Pakoja e poshteme perfaqsohet nga flish ritem holle alvevrolito ranor e ranoro alevrolit , te alteruar me ndonji shtrese ranori te trashe 2m, so dhe thjerza gelqerori mergelor.

Pakoja e sipërme është perfaqësuar nga horizonte vidhësese me olistolite. Shtresëzimi është shumë i dobët, ndërsa olistolitët janë të shumta.





-Informacion per pranine e burimeve ujore ne sipërfaqen e zbatimit te projekti dhe ne afersi te saj

Objekti perbehet nga depozitime te shkembinjve karbonatike te kretakut te poshtem dhe te siperm Cr₂, te cilet karakterizohen me filtrim te lart te ujrave.

Sipas ujembajtjes formacionetgjeologjike klasifikohen

1- Shtresa ujembajttese poroze

- a- Shtresa me perhapje te gjere dhe ujembajtje te madhe
- b- Shtresa me perhapje te kufizuar ose te paqendrueshme ne shtrirje dhe me ujembajtje mesatare ose te ndryshem.

2- Shtresa ujembajttese me carje , karstike me pak pore carje.

- a- Shtresa me perhapje te gjere dhe ujembajtje te madhe
- b- Shtresa me perhapje te gjere dhe ujembajtje mesatare deri ne te vogel

3- Shkembinj te care dhe poroze me ujembajtje locale ose shume te varfer me ujra nentoksore.

- a- Shkembinj te care me ujembajtje locale dhe rezerva te kufizuara deri ne mesatare
- b- Shkembinj te care dhe poroze me ujembajtje locale dhe rezerva te kufizuara
- c- Shkembinj shume te varfer me ujra nentoksore

Meqenese sipërfaqja e formacioneve ku do te kryhet aktiviteti minerar qe perfaqsohen nga gelqerore Cr₂ Kretak i siperm burimet ujore qe dalin ketu jane te vogla. Jane ujra te infiltracionit me rrjedhje te lire karakterizohen nga lekundje sezonale te debitit dhe te niveleve.

Ne perberjen e ujrave prodiminon Anioni hidrokarbonat HCO₃, kurse ne kationet Ca⁺⁺ dhe Mg⁺⁺

Mineralizimi i pergjitheshme ka vlera te uleta nga 161.5mg deri 994.4mg/per liter.Fortesia leviz nga 6.63deri 7.41.

Ujrat jane te pershtateshme per per tu pire dhe per qellime industrial.

Kushtet hidrogjeologjike te venburimit, jane te mira . Mungesa e ujrave nentokesore esht si rezultat i karstit. Edhe gjate shfrytezimit nuk do te kemi problem me ujrat nentokesore.

Te gjith ujrat qe bien ne trajte rreshjesh per nje here filtrojne ne karstin nentokesore qe eshte zhvilluar nen gurin gelqerore .

Objekti ndodhet ne kreshte malore,ne kuoten me te larte te relivit te zones

Ne kontaktin me flishit te cilet nuk jane te pershkueshem nga uji, dalin burimet ujore. Gelqeroret e kretakut qe perbejne vendburimin ne siperfaqe, ndertojne strukturen e vendburimit me zgjatje veriperendim – juglindje, dhe renie verilindore dhe jugperendim . Gelqeroret e vendburimit jane shtresore dhe me çarje, perveç planeve te shtresezimit. Per nga ujembajtja e tyre gelqeroret ne teresi karakterizohen nga nje filtrim i dobishem i larte i reshjeve atmosferike, dhe pershkueshmeri te larte, natyrisht ne vartesi te shkalles se çarshmerise, te shtresezimit, karstezimit dhe nderlikimit tektonik te tyre. Ndersa gelqeroret e vendburimit karakterizohen nga ujembajtje e paket, çka shpjegohet me drenimin e larte te ujrave ne thellesi, kryesisht nepermjet shtresezimit te dukshem dhe çarshmerise se gelqerorve.

Ujerat e drenuar dhe ato siperfaqesore shkarkohen nepermjet perroit te Momiljeshi me rrjedhje ne veri dhe derdhje ne lumin shkumbin dhe prorskave qe rrjedhin ne territorin e fshatit Gjormja dhe me tej derdhen ne lumin Shkumbin.

Meqenese siperfaqja e gelqeroreve eshte e vogel dhe zona e ushqimit eshte e voge. Ujembajtja e ketij kompleksi jane minimale

Kushtet hidrogjeologjike te objektit minerar jane te mira, ujrat nepermjet shtresezimit do te drenojne ne thellesi nga kreshta qe perben pjesen me te larte te objektit minerar, ne pjerresin e shpatit verior dhe shpatin perendimor , drejt lugines. Kryerja e aktivitetit nuk prek burime ujore, ato nuk ekzistojne ne siperfaqen e zones minerare Nr.356/1. Burimi i ushqimit te shtresave ujembajtese jane rreshjet atmosferike.

Ne planshteten hidrogjike K-34-101-A-c dhe tekstin shpjegues(bashkangjitur) te marre nga SH.GJ.SH, ne tabelen perkatese jepet vendodhja e burimeve

- Pershkrimin e Faunes ne secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombetare dhe nderkombetare te tyre

Ne zonen e projektit dhe perreth saj nga gjitaret rriten lepuri, dhelpra. Ndër shpendët më tipik të vegjetacionit janë harabela, gushkuqi, trumcaket etj. Ne zone rriten edhe perfaqesues te zvarranikeve si dhe nje shumellojshmeri insektesh. Mjaft e zakonshme është prania e zvarranikëve, të tillë si breshka e zakonshme (Lat. Testudo hermanni), Zhapiku i gjelbër (Lat. Lacerta viridis), gjarpri shigjetë (lat. Coluber gemonensis), nëpërka me brirë (Lat.Vipera ammodytes), etj. Insektet këtu janë përfaqësuar nga një numër i madh të familjes së brumbujve (brumbujt), grerëzave dhe milingonave, si dhe familjet e fluturave, mushkonja etj. Fauna qe rritet ne zone nuk gezon status te vecante te ruajes kombetare dhe nderkombetare.

- Pershkrimin e zonave te Mbrojtura prane vendit ku propozohet te zbatohet projekti , perfshire edhe monumentet natyrore te mbrojtura me ligj

Sic edhe eshte theksuar aktiviteti i shfrytezimit te mineralit te gurit gelqeror do te zhvillohet ne objektin GJORMA , Bashkia Elbasan , qarku Elbasan. Ne afersi te zones qe do te zhvillohet aktiviteti nuk ka zona te mbrojtura , objekte arkeologjike apo monumente natyrore te mbrojtura me ligj.

Pershkrim i cilesise se mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese

- Cilesia e ujrave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te Thelluar te VNM-se

Nga pikepamja hidrografike zona e marre per studim ka kushte te mira perbehet nga terren shpat me pjerresi te bute ne jug dhe me renie vertikale ne veri. Rrjedhja siperfaqesore e ujerave derdhet ne perroin e Gjorma dhe te Elbasan. Rrjedhjet nentokesore jane karakteristike per depozitimet e gelqeroreve qe filtrojne ne kolektoret e permendur me larte. Ujerat nentoksore jane te pakta e me prurje te vogel.

Zona kufizohet nga perroi Gjorma ne pjesen veriore dhe perendimore, ndersa ne jug nga perroi fushes se Domosdoves qe bashkohet me perroin e Gjorma dhe me tej derdhen ne afersi te Qukesit ne lumin Shkumbin.

Sipas Raportit te Gjendjes se mjedisit per vitin 2016 , Pellgu i lumit Shkumbin, shtrihet tërësisht në zonën e mesme të Shqipërisë. Sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës të ketij lumi është 2445 km² , lartësia mesatare e pellgut rezulton 753,2m, gjatësia e tij 181,4km, pjerrësia mesatare e pellgut 300 /00, dendësia e rrjetit hidrografik 1,9km/km² .

Prurja mesatare shumëvjeçare e aluvioneve pezull është 187kg/sek, kurse turbullira 3040gr/m² . Mineralizimi është 317mg/l dhe përbëhet kryesisht nga bikarbonate. Prurja shumëvjeçare e Shkumbinit në derdhje është 61,5m³ /sek që i përgjigjet një moduli prej 25,2m³ /s/km² . Koefficienti i rrjedhjes për të gjithë pellgun hidrografik është 0,59, moduli i rrjedhjes së aluvioneve pezull 2373 ton/km² /vit. Ushqimi sipërfaqësor i Shkumbinit përfaqëson 61% të rrjedhes vjetore, ndërsa ai nëntokësor 39%.

- Cilesia e ajrit ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se

Persa i perket cilesise se ajrit bazuar ne Raportin e Gjendjes se mjedisit per vitin 2016 nuk jane ber matje ne qytetin e Elbasanit.

Duke qe se ne afersi te zones ku ndodhet kariera nuk zhvillohen aktivitete industriale mudn te themi se ajri ne zone ai konsiderohet brenda parametrave te lejuar duke qen se ndodhet larg zonave te banuara dhe nuk eshte i ndotur nga veprimtarite e industrise. Edhe zhvillimi i aktivitetit te shfrytezimit nuk do te shkaktoj ndotje te ajrit sepse nuk do te kete emetime te gazeve ndotes ne atmosfere. Aktiviteti i shfrytezimit nuk perdor lende djegese gjate zhvillimit te tij.

- Niveli i zhurmave ne zonen e studiuar per hartimin e raportit te thelluar te VNM-se

Persa i perket nivelit te zhurmave bazuar ne Raportin e Gjendjes se mjedisit per vitin 2016 nuk jane ber matje ne qytetin e Elbasanit.

Ne afersi te projektit nuk ka veprimtari te cilat te shkaktojne zhurma mbi nivele te lejuara dhe te shkaktojne ndotje akustike . Zonat me te aferta te banuara ndodhen ne distance dhe nuk preken nga veprimtaria qe do te zhvillohet.

- Administrimi i mbetjeve ne zonen ku propozohet projekti

Administrimi i mbetjeve urbane në vendin tonë është i decentralizuar. Në pjesën më të madhe të qyteteve shërbimet e mbledhjes dhe transportimit të mbetjeve kryhet nga kompani privatë të menaxhimit të mbetjeve, të cilat janë të kontraktuara nga bashkitë. Në shumicën e bashkive të vendit, tarifa për menaxhimin e mbetjeve përfshin grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve deri në venddepozitim. Zonat rurale ne vendin tone nuk janë të mbuluara akoma nga shërbimet e menaxhimit të mbetjeve. Pjesa me e madhe e mbetjeve të këtyre zonave depozitohen nëpër lumenj ose në anë të

rrugëve të cilat pastrohen nga Ujërat dhe në këtë mënyre zhvendosen në një pjesë tjetër toke dhe në fund në rrjedhjet ujore.

Zona ku do zhvillohet aktiviteti është në largësi rreth 2.5 km në vijë ajrore nga qyteti i Elbasan. Mbetjet urbane që do të krijohen nga aktiviteti i përditshëm i punonjësve do të depozitohen në kosha plastike të vecante dhe më pas do të evadohen drejt vendepozitimeve të caktuara nga bashkia Elbasan

Pershkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti

- *Njesia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti*
Aktiviteti do të zhvillohet në zonën minerare nr.356/1, objekti GJORMA, Bashkia, Elbasan.

Ekonomia e zonës dhe aktivitetet kryesore të saj.

Popullsia e zonës merret me punimin e tokës kryesisht me bujqësi, blegtori, pemtari dhe një pjesë punon në aktivitetet private industriale dhe të shërbimit që janë ngritur në këtë zonë.

Aktivitetet kryesore të ngritura janë në veprimtarinë e shërbimit, bar restorante, transport të qytetarëve, pika karburanti, servise, ndërtime në infrastrukture, objekte banimi e industriale, baxho prodhimi të produkteve nga qumështi, etj.

5. NJE PERSHKRIM TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË RENDËSISHME TË PROJEKTIT TË PROPOZUAR MBI MJEDISIN KU PËRFSHIHEN

Ndikimet negative në mjedis

- *Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit*

Gjate dhe pas përfundimit të shfrytëzimit, do të ketë ndryshime të vogla në topografinë lokale. Në projekt është parashikuar një radhë dhe drejtim i tillë i shfrytëzimit për punimet sipërfaqësore, që në kombinim me masat e tjera suplementare të mbushjes, sistemimit dhe trajtimit, parandalojnë erozionin.

Për shmangien dhe parandalimin e erozionit si dhe për ruajtjen e regjimit të rrymës së ujit të parametrave hidrodinamike të saj, në projekt është përcaktuar shfrytëzimi harmonik dhe i kombinuar në kohë dhe hapësirë të zonës në teresi dhe i meandrave të shfrytëzimit.

Në zonën e shfrytëzimit hap pas hapi dhe në përfundim të aktivitetit, është parashikuar mbushja, sistemimi, përpunimi dhe mbulimi i një sipërfaqeje të konsiderueshme.

Kjo sipërfaqe e përfutur nga trajtimet e mesiperme, do të japë mundësi për rikultivimin e bimëve dhe pemëve të ndryshme, duke krijuar njëherësh kushte për parandalimin e erozionit dhe permisimin e pamjes së përgjithshme të zonës së shfrytëzuar. Në përfundim të aktivitetit do të zbatohet plani I mbylljes dhe rimbullimit të zonës së shfrytëzuar.

-Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit

Mbulesa bimëore në zonën ku do të shfrytëzohet përfaqësohet nga shkurret dhe vende-vende ka shfaqje të gelqerorit. Në zonë rriten kryesisht shkoza, bushi, dellinja, pak shqope si dhe përfaqësues të familjes graminore.

Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar dhe e listuar në urdherin e Ministrisë nr.1280, dt.20.11.2013 'Për miratimin e listës së kuqe të flores dhe faunës së eger'. Nga subjekti në

zbatim te projektit do te merren masa qe zona ne shfrytezim te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet. Zona e kerkuar per shfrytezim nuk përfaqëson zone me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme për tu shpallur "Peizazh i mbrojtur".

-Shkarkimet ne mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Gjate fazes normale te operimit te projektit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve te ngurta toksike dhe lende te tjera te demshme qe mund te shkarkohen ne ajer dhe toke, te lidhura me teknologjine e perdorur, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punetoreve, banoreve per rreth, mjedisin floren dhe faunen e zones.

Persa i perket mbetjeve sterile te cilat do te dalin nga aktiviteti i shfrytezimit me punime siperfaqesore do te sistemohen ne sheshin e percaktuar per kete qellim.

Me perfundimin e aktivitetit minerar, do te rehabilitohen plotesisht shkallet e karieres si dhe sheshi i depozitimit te sterileve.

Materiali qe do te depozitohet ne vendet e shfrytezimit eshte i paster dhe me tregues fizik, petrografik, kimik dhe granulometrik te njejte me ate te terrenit rrethues.

Gjithashtu mbetjet e krijuara nga veprimtaria humane e punonjesve do te grumbullohen te kosha plastike dhe me pas do te evadohen ne vendin e caktuar nga bashkia Elbasan

Investitori lidhur me permiresimin e eficenses se perdorimit te sterileve , ne fazen e pare sterilet do te sistemohen ne shesh depozitimin e projektuar dhe ne vazhdimesi 50-60 % do te perdoren per shtrimin dhe mirembajtjen e rrugeve hyrese per ne karriere dhe pjesa tjeter do te ruhet per tu perdorur ne fazen e rehabilitimit te karieres.

Theksojme se keto sterile jane me perberje mineralogjike te njejte me depozitimet e terrenit ku kryhen punimet, prandaj nuk demtojne faunen dhe floren e zones.

Sasia e sterilit, qe do te dale nga shfrytezimi, parashikohet te jete jo e madhe krahasuar me prodhimin. Kjo per dy arsye:

- Mbulesa mbi gelqeroret eshte e vogel per kete objekt krahasuar

- Materiali qe do te prodhohet gjate shfrytezimit dhe hapjes se rrugeve te brendshme, do te perdoret per mbushjen e pikave te dobeta te rruges si dhe pjesa tjeter do te sistemohet ne sheshin e depozitimit per tu perdorur ne fazen e rehabilitimit

-Ndikimet negative shtese (kumulative) ne cilesine e mjedisit ne zonen e projektit dhe burimet natyrore si mineralet, pyjet , burimet ujore

Zhvillimi i aktivitetit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore. Meqenese nuk do te perdoren ne procesin e shfrytezimit lende te demshme, nuk do te kete shkarkime te lendeve kimike te demshme per mjedisin ne ajer, toke dhe uje.

Zhvillimi i aktivitetit nuk prek pyjet e zones.

-Ndikimet sociale te projektit , te tilla si ndryshimi i perdorimit te tokes dhe shqetesimet qe mund te lindin nga ndikimet ne mjedis te projektit (si zhurmat, pluhuri, perdorimi i burimeve natyrore etj).

Zbatimi projektit nuk kerkon ndryshime ne popullsi, spostime te zonave te banuara ose krijimin e zonave te reja banimi, etj. Aktiviteti i shfrytezimit te vendburimit do te behet ne nje zone te kufizuar ne krahasim me siperfaqen dhe popullsine e rajonit. Per zhvillimin e aktivitetit nuk do perdoret toke shtese vec asaj te miratuar per shfrytezim. Zhurmat qe do te krijohen nga mjetet e nxjerrjes,

ngarkimit dhe transportimit te mineralit jane ne nivele te pranueshme dhe nuk do perbejn problem shqetesues per banoret e zones ne afersi.

Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Cdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit.

Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Paisjet e makinerit qe do perdoren ne kete aktivitet do plotesojne direktiven 2000/1/14/CE te Parlamentit Evropian dhe e KE 8 maj 2000, do jene te standartit te aplikueshem ne BE per zhurmat.

Karakteristikat e ndikimeve negative ne mjedis

- *Metodat e zbatuara per parashikimin e ndikimeve negative ne mjedis*

Per vleresimin e ndikimeve ne mjedis te projektit u ndoqen hapat e me poshteme:

-Njohja me projektin dhe teknologjine e tij.

-Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.

-Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes qe do te shfrytezohet.

-Njohja me infrastrukturen egzistuese dhe nevojten per infrastrukture te re per projektin.

-Njohja me lendet e para qe do te perdoren per zbatimin e projektit.

Duke njohur teknologjine, operacionet ne terren dhe menyren e shfrytezimit te objektit u indetifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit ne objekt

Indetifikimi i ndikimeve – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i shfrytezimit te mineralit gur gelqeror dhe u indetifikuan ndikimet e mundeshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

Vleresimi i ndikimeve – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

- *Lloji i ndikimeve te identifikuara (Direkte dhe Jodirekte)*

Ndikimet e identifikuara nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

Tabela e indetifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne toke.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punes.	Behet fjale per ndonje rast te rralle te rrjedhjes gjate difekteve dhe çarje te tubave dhe sotokartit te mjeteve motorike ne makinerite e karieres gjate prodhimit dhe transportit te mineralit.

Tabela e indetifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne ajer.

	Ndikimi i mundeshem	Sqarim
1	Shkarkimi i gazeve ne sasi minimale nga lenda djegese qe punojne automjetet	Sasia e gazeve nga djegia e karburantit qe do te shkarkohet nga mjetet motorrike. Eshte standart i teknologjise se prodhimit te mjeteve dhe i karburantit. Shoqeria do te furnizohet me karburant nga shoqeri te cilat jane te licensuara per tregtimin e

		tij.
2	Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive .	Vlerat standart te emetimit te zhurmave sipas teknologjise se prodhimit te makinerive, kontroll teknik te makinerive.

Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne biodiversitet.

	Ndikimi i mundeshem	Sqarim
1	Shqetesim i mundeshem i faunes.	Ndikim i perkoshem.

- *Mundesia e zbutjes se ndikimeve dhe argumentimet perkatese nese per ndikime te caktuara nuk mund te batohen/ ndermerren masa zbutese*

Referuar natyres se procesit nuk kemi sasi gazesh te shkarkuar ne atmosfere, Gazet prej mjeteve te punes jane ne intervale kohore te shkurtra , brenda normave te lejuara pa ndonje ndikim negativ ne mjedisin perreth. Këto lloj mjetesh emetojnë sasira gazesh të cilat janë rezultat i punës së motorrave me djegie të brendëshme, brënda normave të lejuara. Këto mjete para se të vihen në punë janë objekt i kontrolleve teknike vecanerisht për emetimet e gazta.

Per mbrojtjen nga gazet e motorreve dizel do te merren keto masa :

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore.

Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te konsiderueshme nga zona e shfrytezimit, keto emetime nuk ndikojne ne to.

Gjithashtu nuk do te kete ndikim tek punonjesit e karrieres, floren dhe faunen per rreth saj. Per zbutjen e ketyre ndikimeve mbi punonjesit e karrieres ata do te pajisen me mjete mbrojtese nga pluhuri dhe gazet.

Zhurmat qe krijohen vijne nga levizja e makinerive, jane te pranishme por nuk perbejn rrezik dhe shqetesim per mjedisin sepse zonat e banuara jane ne nje distance te konsiderueshme. Per mbrojtjen nga zhurma te njerezve nga ana e shoqerise do te punohet ne dy drejtime

- Ne karriere do te perdoren makineri dhe pajisje te teknologjise se larte te pajisura me amortizues te zhurmave

- Punonjesit e karrieres do te pajisen me mjete mbrojtese nga zhurmat sipas rregullores se sigurimit teknik.

- *Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve te projektit (zona te mbrojtura dhe habitate, qendra te banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj)*

Si rezultat i zbatimit te projektit ne kete zone nuk ka ndikim negativ mbi ndertimet, trashegimine arkitektonike dhe historike, tiparet arkeologjike dhe mbi vepra te tjera njerezore, sepse ne kete zone nuk ka asnje objekt te nje rendesie te vecante te karaktereve te lartpermendura. Kjo tregon që zona është zonë e lirë jo vetëm për të realizuar shfrytezimin e mineralit gur gelqeror, por njëkohësisht një zonë në të cilën aktiviteti nuk shoqërohet me pasoja ndotëse për mjedisin

6. NDIKIMET NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT (NESE KA TE TILLA)

Vendi ku do te shfrytezohet minerali gur gelqeror ndodhet brenda territorit te vendit tone nen juridksionin e Bashkise Elbasan dhe nuk ka ndikime nderkufitare.

7. NDIKIMET POZITIVË NE MJEDISIN E ZONES SE PROJEKTTIT

Shfrytezimi i burimeve natyrore dhe vecanerisht minerare eshte domosdoshmeri ashtu sic eshte domosdoshmeri shfrytezimi i shume burimeve te tjera natyrore. Shfrytezimi i tyre duhet ber sipas projekteve te hartuara nga ekspertet duke zbatuar ligjet ne fuqi. Si rrjedhoje e zbatimit te projektit per shfrytezimin e gurit gelqeror ne vendburimin e projektuar, nuk ka ndikime pasuese mjedisore. Ne projekt, nuk perfishihen ndryshime ne popullesin e zones, te zhvendosjes se saj per shkak te aktivitetit. Ne territorin e zbatimit te projektit nuk ka qender te banuar, banesat me te aferta jane mbi 2.5 km, prandaj dhe nuk do te kete ndikime ne popullsi.

Zhvillimi i aktivitetit do te bej te mundur shfrytezimin me eficence te mineralit gur gelqeror ne objektin GJORMA dhe perdorimin e tij ne impiantin e fraksionit te cilin shoqeria disponon per prodhimin e inerteve te rendesishme ne industrine e ndertimit.

Zhvillimi i ketij aktiviteti do te sjell ndikim pozitiv ne punesimin e banoreve te zones te cilet kane edhe eksperiencen e duhur ne kete fushe. Punesimi i tyre do te sjell edhe rritjen dhe permiresimin e cilesise se jeteses dhe rritjen ekonomike te zones.

Gjatë zbatimit të aktivitetit nuk do kete ndryshime të rrjetit të rrugëve lokale dhe transportit, madje nga ana e shoqerise do te tregohet kujdes dhe do te mirembahet rruga ekzistuese qe te con ne kariere. Për rrjedhojë aktiviteti nuk do ndikojë absolutisht në rrugët lokale dhe transport, përkundrazi subjekti është angazhuar të mirembajë rrugët lokale të transportit me qëllim të mbarvajtjes së mirë të aktivitetit të tij.

8. MASAT E PROPOZUARA PER MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV TE IDENTIFIKUAR

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve, ne ajer, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit , faunen dhe floren. Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do merren masa per zbutjen dhe minimizimin e efekteve negative ne mjedis

Planifikimi i zones

Per shmangien dhe parandalimin e erozionit si dhe per ruajtjen e regjimit te rrymes se ujit te parametrave hidrodinamike te saj, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne teresi .

Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit, eshte parashikuar sistemi i sterileve qe do te dalin nga aktiviteti rehabilitimi i tyre, si dhe rehabilitimi i shkalleve te karieres me punime siperfaqesore.

Kjo siperfaqe e perftuar nga trajtimet e mesiperme, do te jape mundesi per rikultivimin e bimeve te zones , duke krijuar njeheresh kushte per parandalimin e eriozionit dhe permiresimin e pamjes se pergjithshme te zones .

Masat qe do te merren per zbutjen e ndikimit

Ndikimet mjedisore te projektit do te zbuten duke zbatuar me korrektesi teknikat e meposhtme:

- Piketim te sakte te siperfaqes qe do te shfrytezohet

- Kontrolli i pluhurave nepermjet lagies se zones qe do te shfrytezohet ne forme sprucimi, sidomos ne kohe te thate dhe me ere , mbulimit te mjeteve te transportit dhe levizjes se tyre me shpejtesi te ulet . Nuk do te kete shperthime ne kohe me ere pasi pluhurat mund te tejkalojne kufijt e karieres.
- Mbajtja rezerve e nje depozite uji per sperkatje
- Mirembajtje dhe akordim i duhur i automjeteve dhe pajisjeve gjithashtu ndihmon ne shmangien e efekteve jahste kufijve te karieres.
- Kontrollin e dherave te gjeneruara dhe sistemimin e tyre nepermjet kompakesimit dhe mbjelljes se shkurreve qe do te dalin nga pastrimi dhe mirembajtja me qellim rivegjetacionin e ambjettit perreth perimetrit te zones qe do te shfrytezohet.
- Hapjen e kanaleve te nevojshem me qellim drejtimin e ujerave te shiut dhe parandalimin e erozionit per parandalimin e shembjes se siperfaqes dhe vithisjeve te ndryshme.
- Punet me lende plasese te mireplanifikuar dhe e kontrolluar sipas rregullores te sigurise.
- Kontroll teknik i mjeteve te punes per te parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe aksidentet e mundshme
- Do te zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurit teknik per punonjesit
- Shperthimet do te behen ne orare te caktuara

Masat e zbutjes se ndikimit ne fazen e pergatitjes se objektit per shfrytezim

Nr	Lloji i ndikimit	Masat	Komente
1	Shqetesim i shtreses se tokes. Pershtatje e rruges per te mundesuar hyrjen ne objekt te mjeteve.	Piketim i sakte i siperfaqes qe do te vendoset makineria. Perdorim ne maksimum i rrugeve egzistuese.	Ndikimi mbahet brenda kufijeve natyrale te tij
2	Pastrimi i zones se parkimit dhe mbajtjes se makinerive. (prerje shkurresh dhe bimesh barishtore)	Shmangie ne maksimum e prerjeve te panevojshme. Kombinim i hapesires duke lene shkurret qe nuk pengojne aktivitetin	Do te shmangen prerjet e shkurreve dhe do te lihen individe neper zonen e objekteve per te ruajtur gjenomen, teper e vlefshme per fazen e rehabilitimit
3	Ngjeshje e pjesshme e tokes nga levizja e automjeteve te transportit	Levizje dhe parkim i kamioneve brenda zonave te caktuara.	Do te punohet me makineri
4	Emetim zhurme, gazesh, arome, vibracion dhe pluhuri.	Planifikim paraprak i punes dhe kohezgjatje sa me e ulet e realizimit te operacioneve	Do te ulet koha e zgjatjes se ndikimit.
5	Erozion minimal ne kohe me rreshje	Hapje kanalesh ne anet e rruges dhe shtrim i saj me cakull	Dobesohet efekti i pikes se shiut pra gerryerjes
6	Ndotje e tokes si pasoje e avarive te mekanikes.	Kontroll paraprak i makinerive dhe periodik i vazhdueshem.	Mase teresisht eficente si mase pervec rrethanave te vecanta dhe avari te papritura.
7	Ndikime ne peizazhin, gjeologjine, topografine.	Ne perfundim do te zbatohet plani I mbylljes dhe	Popullim me bimesi te zones

		rehabilitimit.	
8	Ndikime ne boten e gjalle (faunen)	Edhe keto ndikime jane minimale do behet inspektimi i zones para fillimit te operacioneve, monitorim i vazhdueshem gjate fazes se hapjes se shkalleve te karieres do te analizohet me kujdes sjellja me e mire ndaj botes se gjalle, si psh te nderpriten punimet ne faza te caktuara te ciklit vjetor te zhvillimit te biodiversitetit.	T`u krijohen kushtet gjallesave qe levizin ne zone dhe riprodhohen. Kujdesi do te vazhdoje deri ne celjen dhe levizjen e te vegjelve nga folete. Po keshtu edhe per bimesine do te merren masa te tilla si pastrim te pluhurit dhe lagies se luleses dhe organeve te riprodhimit.
9	Gjenerim i mbetjeve te ambalazhe etj	Do te sigurohen vende te veçanta grumbullimi me kosha plastike dhe do te transportohen ne vendgrumbillimin e caktuar.	Ngavet subjekti do tebehet trasnporti I mbetjeve qe do te gjenerohen nga punonjesit drejt vendit te caktuar nga bashkia Elbasan

Masat zbutese te ndikimeve negative gjate procesit te shfrytezimit.

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne uljen e ndotjeve gjate punimeve ne kariere te ajrit nga pluhuri, gazet mbrojtja nga zhurma,si dhe uljen e efekteve negative hapsinore dhe ne territor, ne faunen dhe floren.Por pikesynimi kryesor i studimit mbetet rehabilitimi i tokes dhe evitimi ne maksimum i erozionit.

Masat konkrete qe do te merren gjate punimeve do te jene :

- Mbjellje me fidane e gjithë periferise me te larte te shpatit te territorit gjate shfrytezimit. Kjo mase do te sherbeje edhe per uljen e nivelit te pluhurave dhe zhurmave ne vazhdim te projektit, si dhe te rrise mundesimin per vetegjenerim te drureve ne pjesen e larte me shpatin tjetër te kodres.
- Pemiresimin e bimesise ne te gjitha periferine e karieres me bimesi te zones per te izoluar pjesen e fragmentizuar nga shfrytezimi prej atyre te paprekura nga projekti duke lene mundesine per perhapje te metejshme te ketyre specieve vendase ne territoret fqinje.Te dy keto masa mund te sherbejne si bariera per pluhurin qe mund te nxirret nga aktiviteti eolik gjate shfrytezimit.
- Uljen e prodhimit per stinen e veres duke evituar keshtu me sa te jete e mundur pluhurat. Nga ana tjetër per te ulur efektet negative, gjate periudhave te thata do te perdoret lagia e shesheve te punes dhe sidomos,lagia e materialit te nxjere. Kjo do te mbroje ambjentin nga pluhuri gjate transportit te prodhimit

Rehabilitimi i territorit

Masat rehabilituese do te konsistojne ne :

- Uljen e erozionit
- Restaurimin e habitateve
- Pasurimin e biodiversitetit me speciet natyrore.

-Rritjen e vlerave vizuale dhe rikrijuese te territorit qe do te shfrytezohet.

Se pari shfrytezimi me tarace me lartesi 10 m, eshte bere per te lehtesuar zbatimin e planit te rehabilitimit. Keto taraca do te lejojne si mbulimin e siperfaqes me gjelberim ashtu edhe evitimn e pamjeve te pakendeshme te shpateve vertikale te tarracave qe mund te mbeten zbuluar ne rastet e lartesis se pergjithshme te tarraces rreth 10 m.

Radha e mbjelljeve do te jete nga lart-poshte, duke lejuar mundesine per vetepërhapjen e specieve mbi bazat e aktivitetit eolitik dhe forces se rendeses. Gjeresia e shkalles se taraces do te jete 4m. Kjo lloj mbjellje lejon vetepërhapjen e species, si dhe nuk demton ne rritjen e bimeve pasi nuk pengon dritezimin.

Rehabilitimi i tokes

Per rehabilitimin e tokes, do te shfrytezohen mbetjet e imeta nga materiali i nxjerre dhe do te plotesohet me dhera humusore te pasur me pleh.

Nese do te nevojitet stabilizimi i ketij dheu nje pjese e faqes se pjerret do te behet me trungje te ngulura me thelesi 30 cm, mulciritimi do te jete i thate dhe me kashte, gjethe te bimeve te zones dhe dege. Mulciritimi do te sherbeje si per uljen e humbjeve te farnave nga largimi prej aktivitetit eolik, ashtu dhe per uljen e aktivitetit erodik per sa kohe vegetacioni eshte i pa zhvilluar mire. Mbjelljet do te kene renditjen me largesi fidanesh cdo 10 m, gje qe do ti jape nje kurore dendesi mjaft e mire territorit pas shfrytezimit, dhe lejon dritezimin per veterritjen dhe zhvillimin e bimeve natyrore.

Rehabilitimi i plote i mjediseve te territorit do te jete si me poshte:

Mbjellja e tarracave

-Mbjellje e taracave ne shkallet e karieres

-Filiza 2 vjecare ne periferi

-Mbjellje e filizave 2 vjecare te pemeve dhe lejimi i perteritjes se shkurreve.

Nga vete rehabilitimi i habitateve me perparesi do te marre rritja e abudances se shpendeve dhe zvarranikeve dhe njekohesisht do te shtohen si habitatet ashtu dhe rezervat natyrore edhe per gjitaret e larte si lepuri etj. prej ketej do te rritet edhe mundesia e pranise se mishngrenesve te larte si dhelpra etj.

Kanalet dhe kunetat.

Kunetat dhe kanalet do te bejne qe rrjedhja e ujrave siperfaqore te behet me force rendese, duke perftuar ne kete menyre grumbullimin e tyre dhe me pas depertimin gradual ne toke.

Kombinimi i punimeve te shfrytezimit te karrieres me ato te zbutjes se impakteve mjedisore si dhe punimet rehabilituese, do te kete si pasoje edhe rritjen e numrit te te punesuarve

Kujdesi per punimet rehabilituese nga ana e shoqerise do te vazhdojne te pakten deri ne kater vite pas mbarimit perfundimtar te shfrytezimit te karrieres.

-Krijimin e siperfaqeve per mbjellje , sistemimin, grumbullimi dhe mbjellja.

Per te krijuar siperfaqet per mbjellje, shkurresh ose barishtesh te zones, subjekti parashikon qe ne vitin e pare te beje :

Sistemimin i dherave ne taracat e shesheve te shkalleve per te gjithe siperfaqen qe do te shfrytezohet . Ndryshimet e mundeshme ne ritmet e prodhimit do te reflektohen edhe ne planet e rehabilitimit.


-Punimet e mbylljes trajtimit te sterile dhe rehabilitimit te zones

Elementet e mesiperme jane marre ne konsiderate ne hartimin e projektit te mbylljes dhe llogaritjen e shpenzimeve perkatese per realizimin e tij dhe perkatesisht

-Zonat e shfrytezuara te krijuara nga shfrytezimi do te mbushen me sterilet e depozituara perreth tyre dhe me vone do te mbulohen me dhe aktiv per te mundesuara mbjelljen e pemeve te pershtateshme te zones.

-Do te çmontohen pajisjet

-Ne perfundim do te jete i shoqeruar nga sinjalistika perkatese edhe rrethimi



- *Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese*

Realizimi i objektivave dhe treguesve te pritshem te parashikuar ne projekt do te varet nga respektimi i te gjitha treguesve te percaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe permiresimi i vazhdueshem i kushteve te punes do te çojne perfundimisht ne nje proces pune te kontrolluar me shkarkime brenda normave, duke mos sjelle pasoja per shendetin e njerzve dhe mjedisin perreth.

9. PROGRAMIN E MONITORIMIT TE NDIKIMEVE NE MJEDIS GJATE ZBATIMIT TE PROJEKTIT

Subjekti do te monitoroje aktivitetin e shfrytezimit te mineralit gur gelqeror ne disa drejtime sipas nje programi te hartuar per kete qellim.

Ne pergatitjen e programit te monitorimit mjedisor merret ne konsiderate mundesia e realizimit te nje monitorimi te elementeve me ndikim ne mjedis. Vetemonitorimi aktivitetit nga subjekti do te behet per ata elemente qe parashikohet se kane ndikim negativ ne mjedis.

Te dhenat e marra nga monitorimi do te evidentohen ne regjistrin perkates dhe me rezultatet e matjeve do te informohen organet e administrimit te mjedisit ne qender dhe ne qark.

Te dhenat cilesore, sipas tabelave do te hidhen ne nje regjister qe administrohet nga vete kompania dhe do te dorezohen ne DRM-ne e qarkut perkates sa here eshte e nevojshme, sipas procedurave ligjore dhe rregulloreve.

Masat qe rekomandohen ne monitorim:

-Inspektimi i zones per te kontrolluar shendetin e vegjetacionit.

-Kontrollin e erozionit

- Inspektim per eliminim te pluhurave permes sperkatjes me uje ne forme sprucimi

Indikatorët e mesiperm te monitorimit jane nje nderthurje treguesish me te cilet vleresohet trysnia qe ushtron zbatimi i ketij projekti ne mjedis si dhe gjendja e mjedisit, ndikimit e ndertimit dhe funksionimit te projektit te zbatuar ne kete objekt.

Matja dhe mbledhja e te dhenave per treguesit e mesiperm do te behet konform metodave dhe teknikave shkencore te njohura dhe te pranueshme.

Te dhenat qe do te mblidhen do te vihen ne dispozicion te organeve shteterore dhe te interesuarve te tjere, gjithashtu keto te dhena do te analizohen me qellim permiresimin e performances mjedisore te veprimtarise dhe berjen e korigjimeve te nevojshme.

Per te ruajtur te dhenat mjedisore te veprimtarise do te pergatitet dhe mbahet nje regjister i veçant ku do te hidhen vazhdimisht te dhenat mjedisore.

Subjekti ne baze te kushteve qe do ti vendosen ne lejen Mjedisore do te kryej vetmonitorimin e aktivitetit nga laborator mjedisor te akredituar.

10. PLANI I MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TE MJEDISIT

- rolet dhe pergjegjesite per zbatimin e seciles mase te propozuar per mbrojtjen e mjedisit ne secilen faze te projektit

Problemet e gjenerimit te mbetjeve dhe administrimit te tyre jane minimale.

Veprimtaria e shfrytezimit te gurit gelqeror eshte veprimtari minerare. Ajo do te zbatohet me punime siperfaqesore. Si rezultat i kesaj veprimtarie prodhohet minerali gur gelqeror i rendesishem ne industrine e ndertimit.

Per menaxhimin e mbetjeve te cilat gjenerohen gjate procesit te punes bazuar ne ligjin 10463 date 22.09.2011 investitori do te zbatoj kete praktike pune e cila eshte pasqyruar edhe ne planin e rehabilitimit :

Brenda siperfaqes se miratuar do te vendoset sheshi i depozitimit te sterileve.

Investitori lidhur me permiresimin e eficenses se perdorimit te sterileve , ne fazen e pare sterileve do te sistemohen ne shesh depozitimin e projektuar dhe ne vazhdimesi 50-60 % do te perdoren per shtrimin dhe mirembajtjen e rrugeve hyrese per ne kariere dhe pjesa tjeter do te perdoret ne fazen e rehabilitimit.

Theksojme se keto sterile jane inerte me perberje mineralogjike te njejte me depozitimet e terrenit ku kryhen punimet, prandaj nuk demtojne faunen dhe floren e zones.

Persa i perket mbetjeve te cilat do te dalin nga aktiviteti i perditshem i punonjesve ato do te grumbullohen ne kosha plastike te vecante dhe me pas do depozitohen ne vendin e caktuar nga bashkia Elbasan nga vet subjekti.

11. KONKLUZIONE

- Aktiviteti qe do te zhvillohet nuk do te kerkoj siperfaqe shtese vec siperfaqes se miratuar pasi do te respektohen kufijt sipas koordinatave te percaktuara.
- Me e rendesishme per tu theksuar ne perfundim te ketij raporti te VNM-se eshte se ai do ti vij ne ndihme mbrojtjes se mjedisit
- Territori ku do te shfrytezohet minerali i gurit gelqeror nuk ka ndonje status te vecante qe pengon fillimin minerar ne kete objekt
- Me masat qe do te merren aktiviteti nuk do te kete ndikime negative ne toke dhe nuk do te ndikojne ne ujerat siperfaqesore dhe nentokesore sepse nuk shkarkon ujera te ndotura. Sterilet qe dalin nga procesi i shfrytezimit nuk shkaktojne ndotje te tokes sepse kane te njejnten perberje mineralogjike me te.
- Ne perfundim te aktivitetit do te zbatohet plani i mbylljes dhe rehabilitimit te siperfaqes qe do te preket nga shfrytezimi.
- Aktiviteti i shfrytezimit te gurit gelqeror ne objektin GJORMA do te kete impakt pozitiv pasi do te ndihmoj ne hapjen e vendeve te reja te punes, per popullsine e zones si rrjedhoje do te kete permiresim te cilesise se tyre te jeteses.

Permbledhja Joteknike e Vleresimit te Ndikimit ne mjedis u pergatite nga

STUDIO PROJEKT shpk

Ekspert Mjedisi Ing. Miniere Xhevair DERMISHI

Gjeoinxhinier Ermir DERMISHI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 331 Prot.

Tirane, me 09.09. 2004

Vendimi Nr.11, Nr.086Regj.

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.268, datë 24.04.2003 "Për çertifikimin e specialistëve, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Xhevair DERMYSHI

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

MINISTRI

Ethem RUKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Zhvillimit Ekonomik,
Tregtisë dhe Sipërmarrjes

LICENCË



LN-0042-06-2009	NUIS/NIPT: K62021001S
Subjekti: STUDIOPROJEKT	
Adresa: Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE, Rruga Frosina Plaku (Perballë Klubi Partizani), 51/6	
Kodi: III.2.A (1+2)	Kod tjetër:
Data e lëshimit: 27/03/2014	Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike
1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis (Auditim mjedisor, vlerësimi i ndikimit në mjedis)

Kufizime specifike
Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike
Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë
Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Nënshkrimi i sportelit: *Doljma Stojà*

